REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE
NACIONALNI AUTORITET ZA KVALIFIKACIJE
NATIONAL QUALIFICATION AUTHORITY
Nr.Prot: 71/12 Data: 06.09.2012
Br. Prot: Datum:
Prot. No.: Date:
PRISHTINË/PRIŠTINA/PRISTINA

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Numër: 71/12
Datë: 06.09.2012

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 1/2011- Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4,7,10 dhe 16, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 04.09.2012 nxjerr këtë:

VENDIM

1. Qendra e Trajnimit "DTC Diakonie", Mitrovicë, duhet plotësuar kushtet deri në afatin e caktuar (01.06.2013), për të marr akreditim dhe aprovim për këtë/o kualifikime:

1.1. Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit; niveli i KKK-së: (III)

Kushtet:

- Të zbatohen Standardet Profesionale apo ndonjë standard ndërkombëtar;
- Të zbatohet lista e kontrollit me rastin e vlerësimit rezultateve të punimit praktik;
- Gjatë punës praktike kandidati në stacionin e punës duhet të këtë prezent materialin e njësisë modulare;
- Është e nevojshme të bëhet kompletimin i kabinetit me pajisje shtesë. Mungojnë pajisjet për testimin e rrjetit;
- Trajnim i trajnerëve për kandidatë me aftësi të kufizuara;
- Të hartohet plani për zhvillimin profesional të stafit;
- Zbatimi i plotë i procedurave të sigurisë dhe mjeteve mbrojtëse ne punë.

- Formularët te cilët i përdorin për kompletim te dokumentacionit të azhurnohen dhe të standardizohen.

1.2. Instalues Elektrik; niveli i KKK-së: (III)

Kushtet:

- Kandidati gjatë punës praktike në punëtori të kenë prezent materialin e njësisë modulare me sqarime dhe skema si dhe hapat e punës për detyrën konkrete (materiali ekziston pjesërisht vetëm për pjesën teorike dhe nuk është i strukturuar mirë, ka mungesë të skemave elektrike dhe simboleve, pjesa praktike e materialit mungon tërësisht). Paketa mësimore të zhvillohet në bazë të standardit profesional për instalues elektrik e cila është e organizuar në 11 module me rezultate mësimore brenda tyre, ose të merret prej qendrave profesionale të cilat e kanë punuar detajisht. Gjithashtu edhe mënyra e testimit të bëhet në bazë të kësaj pakete me test hyrës, testet modulare teorike dhe praktike, testi përfundimtar teorik dhe praktik;
- Nuk ka vend për sistemimin e veglave të punës (veglat ekzistojnë por nuk janë të renditura mirë, ka vështirësi në gjetjen dhe mirëmbajtjen e tyre;
- Panelet punuese nuk janë të mbrojtura sipas standardeve për mbrojtjen dhe sigurinë e personave që punojnë me to (ekziston vetëm një çelës diferencial në kutinë kryesore, por ai është me rrymë provokimi 0.5A, ndërsa rekomandohet për secilin panel të jetë 0.03A). Të zëvendësohen me të reja në formë rrjete dhe me mbrojtje adekuate të cekur më lartë;
- Vendosja e udhëzimeve për secilin panel të ushtrimeve;
- Materiali i punës praktike është i mangët dhe nuk është i regjistruar dhe nuk është i renditur me listë.

1.3. Instalues i Ngrohjes; niveli i KKK-së: (III)

Kushtet:

- Zhvillimi i kurrikulave për Instalues të ngrohjes (përshkruesit e moduleve) të bazuar ne standardet kombëtare ose ndërkombëtare të kualifikimit përkatës:
- Hartimi i pakove mësimore cilësore sipas kurrikules së zhvilluar sipas pikës më lartë;
- Sigurimi i pajisjeve dhe materialeve të trajnimit ne cilësinë dhe sasinë e duhur për të zbatuar programin e trajnimit;
- Të bëhet standardizimi i formularëve te cilët përdoren për kompletim te dokumentacionit;
- Të zhvillohen instrumentet e vlerësimit (listë kontrolli, teste për vlerësim të pjesshëm dhe përmbledhës);
- Të zhvillohen module të veçanta për siguri në punë.

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit, me datë:04.09.2012, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi

Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:
-Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit;
-Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
-Raporti i Vetë-vlerësimit;
-Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1. Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK deri më 01.06.2013.
AKK mbledh panelin vlerësues të përbërë nga tre ekspert të fushave përkatëse, për verifikimin e kushteve të caktuara nga ky vendim.

3.1 Në bazë të rezultateve dhe rekomandimeve të dala nga vizita e eksperteve, KD i AKK-së do të marr vendimin për aprovim/akreditim ose mos aprovim/akreditim.

3.2 Institucionit Q.T "DTC Diakonie" obligohet që të marr mbi vete shpenzimet për ekspert (një ditë pune sipas UA nr.1/2011), Institucioni është i liruar nga pagesat tjera administrative.

4. Kushtet tjera të parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

5. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

6. Vendimi u dërgohet:

- QT "DTC Diakonie";
- AKK-së.

Kryetari i KD së AKK-së
Ragip Gjoshi